

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Raporti 09/2005 i Shtyllës së III-të (OSBE) Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 22 tetor – 25 nëntor 2005

Titujt kryesor

- Kuvendi miraton rezolutën për “rekonfirmimin e vullnetit të popullit të Kosovës për Kosovën Shtet të pavarur dhe sovran”
- Kuvendi miraton nismën për hartimin e kushtetutës së re të Kosovës
- Mocioni i interpelancës i PDK-së dhe propozimi i ORA-s për debatet plenare lihen jashtë rendit të ditës së Kryesisë edhe pse ishin dorëzuar mjaft kohë para afatit
- ORA propozon seancë të jashtëzakonshme plenare për të diskutuar parregullsitë e mundshme në vendimin për ndërtimin e qendrës administrativo-protokollare në Gërmi dhe shpenzimet buxhetore të Kuvendit
- Shtyhet formimi i Komisionit parlamentar për siguri
- Vështirësitë e vazhdueshme procedurale dhe vonesat në miratimin e legjislacionit dhe nismave të tjera të rëndësishme theksojnë nevojën për seanca më të shpeshta plenare

1. Sfond

Raporti i dyzetënjëtë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej 26 nëntor 2002 dhe bazohet në pajtueshmërinë me Rregulloren e re të punës të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur një seancë plenare, më 17 dhe 21 nëntor, dhe një mbledhje të rregullt të Kryesisë më 1 nëntor. Të gjitha komisionet si dhe nënkomisioni i sapothemeluar për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike i kanë mbajtur mbledhjet gjatë kësaj periudhe.¹ Shtylla e tretë (OSBE) e ka monitoruar seancën plenare dhe mbledhjen e Kryesisë, si dhe 26 prej 30 mbledhjeve të komisioneve dhe dy dëgjime publike.²

¹ Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese është takuar më 31 tetor, 7 dhe 14 nëntor, derisa Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim është takuar më 31 tetor. Komisioni për buxhet dhe financa është takuar më 27 tetor, 2, 9 dhe 24 nëntor, derisa Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion është takuar më 25 tetor, 1 dhe 8 nëntor. Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media është takuar më 25 tetor, 10 dhe 24 nëntor, derisa Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe personat e zhdukur është takuar më 25 tetor, 1, 10 dhe 15 nëntor. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport është takuar më 25 tetor, 9 nëntor dhe 14 nëntor, derisa Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike është takuar më 27 tetor dhe 18 nëntor. Komisioni për gatishmëri emergjente është takuar më 26 tetor dhe 14 nëntor, derisa Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor është takuar më 2 dhe 8 nëntor. Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike është takuar më 25 tetor, 1 dhe 8 nëntor. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport ka mbajtur dy dëgjime publike: Dëgjimin publik të projektligjit për edukimin parashkollor më 26 tetor, dhe Dëgjimin publik të projektligjit për trajnimin dhe edukimin profesional më 7 nëntor.

² Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese më 31 tetor, 7 dhe 14 nëntor; Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim më 31 tetor; Komisioni për buxhet dhe financa më 27 tetor, 2 dhe 9 nëntor; Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion më 25 tetor dhe 1 nëntor; Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media më 25 tetor dhe 10 nëntor; Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe personat e zhdukur më 25 tetor, 1, 10 dhe 15 nëntor; Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport më 25 tetor dhe 14 nëntor; Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike më 27 tetor dhe 18 nëntor; Komisioni për gatishmëri emergjente më 26 tetor dhe 14 nëntor; Komisioni për

2. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 17 dhe 21 nëntor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci (LDK) më 17 nëntor dhe më 21 nëntor deri në pauzë dhe nga anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK) pas pauzës më 21 nëntor.

- Njëqind e katër dhe 83 deputetë ishin të pranishëm më 17, përkatësisht 21 nëntor.³
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 17 dhe 21 nëntorit 2005:
 - Miratimi i rezolutës për Kosovën Shtet të pavarur dhe sovran (Rezoluta është miratuar me aklamacion.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për investimet e huaja (Projektligji ishte miratuar me 79 vota për.⁴)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për dizajnin industrial (Projektligji është miratuar me 72 vota për.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për akreditimin (Projektligji ishte miratuar me 73 vota për.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ushqimin (Projektligji është miratuar në parim me 74 vota për.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për veprimtarinë botuese dhe librin (Projektligji është shtyrë për seancën e ardhshme. Shiko pikën e parë nën titullin “Përfaqësimi i Qeverisë në seancat plenare”.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për institucionet e kulturës (Projektligji është shtyrë deri në seancën e ardhshme. Shiko pikën e parë nën titullin “Përfaqësimi i Qeverisë në seancat plenare”.)
 - Shqyrtimi i propozimit për fillimin e procedurës për hartimin e Kushtetutës së Kosovës (Propozimi është miratuar me 70 vota për dhe pa vota kundër.⁵)
 - Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për siguri (Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë. Shiko “Formimi i Komisionit për siguri”.)
 - Shqyrtimi i propozimit për formimin e një komisioni parlamentar ad-hoc për t’i rekomanduar Kuvendit emërimin e anëtarëve në Këshillin e Komisioni të Pavarur të Mediave (Propozimi është miratuar me 79 vota për, gjashtë vota kundër dhe katër abstenime.)
 - Përgjigja e Kryeministrit të Kosovës në pyetjen e deputetit Ramadan Kelmendi (LDK) (Shiko pikën e parë nën “Pyetjet për Qeverinë”.)
 - Përgjigja e Kryeministrit të Kosovës në pyetjen e deputetit Berat Luzha (PDK) (Shiko pikën e parë nën “Pyetjet për Qeverinë”.)

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Rendi i ditës

- Rendi i ditës i seancës plenare të 17 dhe 21 nëntorit nuk është paraqitur për miratim në Kuvend, qoftë në fund të seancës së mëparshme apo në fillim të seancës më 17 nëntor. Në mënyrë të ngjashme, rendi i ditës për seancën e ardhshme nuk është paraqitur për miratim në Kuvend në fund të seancës më 21 nëntor.

bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor më 8 nëntor; Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike më 25 tetor dhe 8 nëntor; Dëgjimin publik të projektligjit për edukimin parashkollor më 26 tetor, dhe Dëgjimin publik të projektligjit për trajnimin dhe edukimin profesional më 7 nëntor.

³Këto ishin shifrat e njoftuara nga Kryetari i Kuvendit në fillim të secilës ditë të seancës plenare.

⁴ Votat kundër dhe abstenimet nuk ishin njoftuar, përveç nëse në raport është bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër. Pasi që janë përdorur pajisjet elektronike për votim, i tërë rezultati i votimit është treguar në ekranin në ballë të sallës plenare, por shifrat nuk mund të shihen nga pjesa e vëzhguesve në fundin e sallës plenare.

⁵ Numri i abstenimeve nuk ishte njoftuar dhe nuk ishte i dukshëm nga galeria e vëzhguesve. Shiko fusnotën 4.

Kjo është në kundërshtim me rregullën 23.1, e cila kërkon që rendi i ditës për cilëndo seancë plenare të propozohet nga një anëtar i Kryesisë dhe të miratohet nga Kuvendi gjatë seancës së mëparshme. “Në fund të çdo seance, Kryetari i Kuvendit, ose një anëtar tjetër i Kryesisë, propozon rendin e ditës të seancës së ardhshme. Ky propozim konsiderohet i miratuar, përveç në rastet kur një ose më shumë grupe parlamentare ose... gjashtë deputetë e kundërshtojnë këtë.” Siç është përmendur në të gjitha raportet e mëhershme që nga shkurti i vitit 2004 e tutje, caktimi i rendit të ditës është bërë tejet problematik që kur ka filluar Kuvendi të mbajë seancat plenare mujore në shkurt 2004. Në mbledhjet e saj para secilës seancë plenare, Kryesia as që provon të përpilojë rendin e ditës për seancën që vjen pas seancës së radhës, për shkak të paqartësisë në lidhje me atë se cilat pika do të jenë të gatshme për shqyrtim një muaj më vonë. Edhe pse Rregullorja është ndryshuar në mënyrë që të reflektojë miratimin e sistemit mujor të seancave plenare⁶, dispozita që kërkon paraqitjen dhe miratimin e secilit rend dite të seancës plenare në fund të seancës së mëparshme ka mbetur. Nëse nuk është e mundshme për Kryesinë që të propozojë rendin e ditës të seancës plenare një muaj më herët, atëherë Kuvendi duhet ta shqyrtojë mundësinë e ndryshimit të rregullores në pajtim me këtë. Për më tepër, nëse Kryesia nuk është në gjendje ta paraqesë rendin e ditës për miratim në Kuvend në seancën e mëparshme, siç kërkohet me Rregulloren, atëherë Kryesia duhet që – më së paku – ta paraqesë rendin e ditës për miratim në Kuvend në fillim të seancës plenare në fjalë. Rregullorja e parasheh qartë se edhe pse Kryesia e propozon rendin e ditës, në fund të fundit është e drejtë e Kuvendit ta miratojë apo refuzojë rendin e ditës. Sidoqoftë, është bërë praktikë që gjatë seancës plenare të mos ndahet kohë për paraqitjen e rendit të ditës për miratim në Kuvend, qoftë në fund të seancës së mëparshme apo në fillim të seancës në fjalë. Çfarëdo shqyrtimi i rendit të ditës varet nga ajo nëse deputetët i ipet fjala për të propozuar ndryshimin e rendit të ditës para se Kuvendi të vazhdojë me pikën e parë të rendit të ditës. Në shumë raste, Kryetari i Kuvendit ose kryesuesi ka proceduar menjëherë me pikën e parë të rendit të ditës, duke mos i lënë fare mundësi Kuvendit që ta kundërshtojë rendin e propozuar të ditës.

- Në mbledhjen e Kryesisë më 1 nëntor z. Gazmend Muhaxheri (ORA) e përmendi se grupi i tij parlamentar ka dorëzuar më 25 tetor një propozim për të mbajtur një seancë plenare për të diskutuar “krizën në arsimin në Kosovë”, si dhe keqmenaxhimin e buxhetit të Kuvendit, dhe pyeti pse propozimi nuk u ishte shpërndarë anëtarëve të Kryesisë dhe nuk ishte përfshirë në rendin e ditës për takimin e asaj dite. Sekretari i Kuvendit Isuf Demaj u përgjigj se materialet për takimin e Kryesisë tashmë u ishin shpërndarë anëtarëve të Kryesisë kur ORA e kishte dorëzuar kërkesën e saj. Grupi parlamentar i PDK-së poashtu e kishte dorëzuar një mocion më 25 tetor me të cilin e ftonte Ministren e Shërbimeve Publike Melihate Tërmmkollli (LDK) në interpelancë (shiko pikën e parë nën titullin “Interpelancat”), që ngjashëm nuk ishte përfshirë në rendin e ditës të seancës plenare dhe nuk u ishte shpërndarë anëtarëve të Kryesisë për shqyrtim. Rregullorja nuk e saktëson afatin kohor për dorëzimin e materialeve për shqyrtim në mbledhje të Kryesisë, e një afat i tillë as nuk përcaktohet me ndonjë vendim apo udhëzim plotësues. Anëtarëve të Kryesisë u është thënë në disa raste se dokumentet e planifikuara për shqyrtim në mbledhje të Kryesisë duhet të dorëzohen së paku dy ose tri ditë pune para mbledhjes së Kryesisë, në mënyrë që të lihet kohë për shpërndarjen e dokumentave anëtarëve të Kryesisë dhe që të përfshihen në rendin e ditës së mbledhjes. Megjithatë, nuk ekziston një afat i saktë kohor i njohur për të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe për administratën. Edhe propozimi për debat plenar edhe mocioni për interpelancë janë dorëzuar pesë ditë para mbledhjes, domethënë mjaft kohë para ndonjë afati qoftë dy ose tre ditë të përmendur në të kaluarën. Pohimi se dokumentet janë dorëzuar pas shpërndarjes së materialeve tjera anëtarëve të Kryesisë nuk është arsye për mospërfshirjen e pikave në rend të ditës dhe është i barasvlefshëm me ndryshimin e afatit kohor në mënyrë arbitrare dhe pa paralajmërim. Oë procedura e caktimit të rendit të ditës të jetë më

⁶ Rregulla 22.4: “Seanca e Kuvendit, në kushte të rregullta, mbahet së paku një herë në muaj, brenda një jave plenare. Java plenare fillon, zakonisht, të mërkurën e katërt të muajit dhe përfundon të premten. Kryesia mund t’i shmangët këtij rendi kur e konsideron të nevojshme.” Vëreni se Rregullorja lejon që seancat plenare të mbahen më shpesh se një herë në muaj.

transparente, është e nevojshme që të caktohet një afat kohor i saktë dhe i qëndrueshëm, dhe për të cilin të gjithë anëtarët do të informoheshin në mënyrë të duhur.

Rregulla 25 parasheh që Kryesia ia përcjell mocionin e interpelancës Qeverisë “menjëherë sapo ta ketë marrë tekstin e interpelancës”. Jo vetëm që mocioni për interpelancë nuk është përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së Kryesisë më 1 nëntor, por nuk është thirrur as mbledhja e rregullt e Kryesisë gjatë pjesës së mbetur të periudhës raportuese⁷, duke rezultuar në shtyerje të konsiderueshme të interpelancës. Kryesia do të duhej ta mbante pa vonesë një mbledhje për të shqyrtuar propozimin e ORA-s dhe mocionin për interpelancë, si dhe propozimin për të mbajtur një seancë plenare të jashtëzakonshme (shiko pikën e ardhshme).

- Më 7 nëntor, grupi parlamentar ORA e ka dorëzuar, së bashku me 40 nënshkrime të deputetëve në mbështetje të nismës, një mocion për ta mbajtur një seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar (1) mënyrën se si ishte marrë vendimi për ndërtimin e “Qendrës administrativo-protokollare” në Parkun e Gërmisë, dhe (2) shpenzimet buxhetore të Kuvendit gjatë gjysmës së parë të vitit 2005. Si arsye për seancën plenare, ky mocion citonte domosdoshmërinë e përcaktimit nëse kishte pasur parregullsi procedurale në procesin e vendimmarrjes dhe ndarjen e fondeve të Kuvendit për shpenzime kapitale dhe shpenzime të tjera. ORA poashtu e ka dorëzuar një mocion, në të cilin citonte rregullën 7.2, dhe me të cilin kërkonte që Kryetari i Kuvendit ta thirrte një mbledhje të Kryesisë për ta shqyrtuar mocionin për seancën e jashtëzakonshme plenare.

Sipas rregullës 23.5, “Kryesia . . . si përgjigje ndaj kërkesës së bërë . . . jo më pak se një të tretën, përkatësisht 40 deputetë në Kuvend, seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit, në mënyrë që ta trajtojë një çështje të ngutshme. Kërkesa duhet të përmbajë çështjen ose çështjet që do të shqyrtohen si dhe arsye për ato konsiderohen të ngutshme dhe të rëndësishme që edhe në mënyrë të tillë të shqyrtohen në Kuvend. Në raste të tilla shqyrtohen vetëm çështjet që përbëjnë bazën e kërkesës.” Rregulla 7.2 parasheh që “Kryetari i Kuvendit e thërret mbledhjen e Kryesisë nëse kërkohet nga një grup parlamentar, ose nga pesë për qind, përkatësisht 6 deputetë të Kuvendit.” Gjatë periudhës raportuese (që përfundon më 25 nëntor) asnjë mbledhje e Kryesisë nuk është thirrur në përgjigje të kësaj kërkesë.

Shpërndarja e dokumentave

- Projektligji për veprimtarinë botuese dhe librin është shpërndarë më 27 korrik; projektligji për ushqimin u është shpërndarë deputetëve të Kuvendit më 14 shtator; dhe projektligji për institucionet e kulturës është shpërndarë më 6 tetor. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 82, 47, përkatësisht 31 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë të caktuar për seancën plenare të 21 nëntorit.

Caktimi i shqyrtimit të parë të projektligjeve më 21 nëntor nuk ishte në pajtim me rregullën 35.1, e cila kërkon që shqyrtimi i parë i projektligjit të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij. Meqë Kuvendi i mban seancat plenare vetëm një herë në muaj, është jashtëzakonisht e vështirë të caktohet shqyrtimi i parë i secilit projektligj jo më herët se dhjetë ditë pune dhe jo më vonë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij, siç kërkohet me Rregulloren e Kuvendit. Nëse, për shembull, një projektligj i dorëzohet Kuvendit dhe shpërndahet gjatë javës së tretë të muajit dhe seanca plenare mbahet gjatë javës së katërt, siç parashihet me Rregulloren e punës, projektligji nuk mund të shkojë në shqyrtim të parë gjatë po atij muaji, sepse deputetët e Kuvendi nuk do të kishin dhjetë ditë për ta studiuar projektligjin para shqyrtimit të parë. Nëse, atëherë, shqyrtimi i parë bëhet gjatë javës së katërt të muajit të ardhshëm, pasi të kenë kaluar për afërsisht pesë javë pune nga shpërndarja e projektligjit deri në shqyrtimin e tij të parë, duke shkelur kështu rregulloren. Kufizimi maksimal prej tri javë pune nga shpërndarja e projektligjit deri në shqyrtimin e tij të parë, që ishte shtuar nga vetë Kuvendi gjatë ripunimit të Rregullores së punës, është i realizueshëm vetëm nëse Kuvendi mban seanca plenare çdo javë ose së paku çdo dy javë.

⁷ 22 tetor – 25 nëntor 2005.

Procesi i votimit

- Kishte kuorum për të gjitha votimet në seancën plenare në fjalë.
Kjo ishte në pajtim me nenin 9.1.32 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullën 31.1 e cila parasheh që për marrjen e vendimeve të jetë e pranishme shumica e deputetëve.

Përfaqësimi i Qeverisë në seanca plenare

- Pas shqyrtimit të parë të projektligjit për ushqimin më 21 nëntor, Kryesuesi i seancës plenare lajmëroi se dy projektligjet e radhës të caktuar për shqyrtim të parë nuk mund të paraqiteshin sepse Ministri përkatës (Ministri për kulturë, rini, sporte dhe çështje jorezidente, Astrit Haraqija) nuk ishte i pranishëm. Zëvendësministri për kulturë, rini, sporte dhe çështje jorezidente Angjelina Krasniqi provoi të fliste, duke lënë të kuptohet se ajo do t'i paraqiste projektligjet në vend të Ministrit Haraqija. Kryesuesi u përgjigj se Kuvendi kishte vendosur që zëvendësministrat nuk mund të paraqesin projektligje në seanca plenare, duke argumentuar se zëvendësministrat mund t'i zëvendësojnë Ministrat në mbledhjet e Qeverisë, por jo edhe në Kuvend. Kryesuesi më pas vazhdoi me pikën tjetër të rendit të ditës.

Në asnjë dispozitë të Rregullores së Kuvendit nuk përmendet roli i zëvendësministrave, përkatësisht as nuk lejohet e as nuk ndalohet pjesëmarrja e tyre në seanca plenare. Nëse Kuvendi dëshiron të përcaktojë kushtet për pjesëmarrjen e zëvendësministrave në mbledhjet e Kuvendit, mund të kërkojë nga Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativë dhe Kornizë Kushtetuese që të japë një mendim ligjor për këtë çështje. Në mungesë të çfarëdo akti relevant ligjor të Kuvendit, kjo çështje rregullohet vetëm me Rregulloren e Qeverisë. Neni 77.2 i Rregullores së Qeverisë parasheh që “në rast të mungesës së ministrit që ka për të prezentuar një projektligj atë e zëvendëson zëvendësministri, e në mungesë të këtij të dytit Kryeministri, zëvendëskryeministri ose një ministër tjetër i caktuar nga Kryeministri.” Nuk është në fushën e përgjegjësisë së këtij raporti mbi monitorimin e Kuvendit që të komentojë më tutje rreth asaj nëse Qeveria vepron në përputhje me Rregulloren e saj.⁸

Pyetjet për Qeverinë

- Më 13 korrik 2005, z. Ramadan Kelmendi (LDK) i ka dorëzuar tri pyetje për Kryeministrin, në lidhje me rindërtimin e shtëpive të shqiptarëve në veri të Mitrovicës, anulimin e Urdhërësës administrative 2002/26 mbi vetëqeverisjen komunale të veriut të Mitrovicës/Mitrovica⁹, dhe rindërtimin e një xhamie në veri të Mitrovicës. Kërkesa e z. Kelmendi përfshinte një paragraf në të cilin thuhej se ajo ishte e mbështetur në rregullën 26.4 të Rregullores së Kuvendit dhe se ai “shpreson(te) se do të marrë përgjigje me gojë” në pyetjen e tij. Z. Berat Luzha (PDK) i ka dorëzuar më 8 shtator dy pyetje për Kryeministrin lidhur me pezullimin e Ligjit mbi lojërat e fatit dhe veprimtarinë e kompanisë “Swiss Lotto”. Në pyetjen e z. Luzha nuk thuhej shprehimisht se ai priste përgjigje me gojë, por ajo përmbante një paragraf në të cilin thuhej se kërkesa bazohej në rregullën 26 të Rregullores së Kuvendit, e cila merret vetëm me pyetjet që kërkojnë përgjigje me gojë. Të dy grupet e pyetjeve për Kryeministrin ishin përfshirë në rendin e ditës të seancës plenare të 17/21 nëntorit si dy pika të fundit të rendit të ditës. Kryeministri nuk ishte i pranishëm në seancë plenare kur këto pika ishin diskutuar.¹⁰ As Kryesuesi as ndonjëri prej deputetëve të Kuvendit (përveç z. Luzha, shiko më poshtë) nuk lanë të kuptohet se kishin pritur që Kryeministri të ishte i pranishëm në seancë plenare për t'u përgjigjur me gojë. Kryesuesi përmendi se Kryeministri nuk ishte i pranishëm, por lajmëroi se ishin dorëzuar përgjigjet me shkrim dhe pyeti z. Kelmendi dhe z. Luzha nëse kishin vërejtje në përgjigjet. Z. Kelmendi u përgjigj se ishte i kënaqur me përgjigjen që kishte marrë, por z. Luzha deklaroi se nuk ishte i kënaqur me përgjigjen në pyetjet e tij, dhe shtoi se ai kishte kërkuar përgjigje *gojore* dhe u ankua se Qeveria po i neglizhonte përgjegjësitë e saj ndaj Kuvendit.

⁸ Shiko raportin 01/2005 dhe 05/2005 të shtyllës III (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

⁹ Z. Kelmendi e ka pyetur Kryeministrin se kur do të anulohet Urdhëresa administrative. Kryeministri është përgjigjur se IPVQ-të aktualisht nuk kanë kompetenca për anulimin e çfarëdo akti të miratuar nga UNMIK-u.

¹⁰ Dihej se ai ishte në takim të grupit negociator atë pasdite, në kohën kur janë diskutuar pyetjet në seancë plenare

Të dytë, edhe z. Kelmendi edhe z. Luzha kishin kërkuar përgjigje gojore në pyetjet e tyre. Edhe pse në kërkesën e z. Luzha nuk thuhej shprehimisht se kërkonte “përgjigje gojore”, në kërkesë megjithatë citohej rregulla 26, e cila merret vetëm me përgjigjet gojore, e jo me përgjigjet me shkrim. Sidoqoftë, duket se Kryesia i ka përfshirë pyetjet në rendin e ditës duke mos pritur që Kryeministri t’i paraqesë përgjigjet gojarisht në seancë plenare. Është dashur të kërkohej nga Kryeministri që të përgjigjet gojarisht në të dy grupet e pyetjeve.¹¹

Interpelanca

- Më 25 tetor, PDK-ja ka dorëzuar një mocion për interpelancë, përfshirë nënshkrimet e deputetëve të saj, me të cilin kërkohej që Ministria për shërbime publike Melihate Tërkkolli (LDK) t’u përgjigjet pohimeve për shkelje të Ligjit për menaxhimin e financave publike, Ligjit për prokurim publik, dhe Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 mbi shërbimin civil në Kosovë. Mocioni i interpelancës e akuzonte më tutje znj. Tërkkolli për “shkarkim masiv të shërbyesve civil nga vendet e tyre të punës, gjithnjë me motive politike” që kur ajo është bërë Ministre. Edhe pse mocioni për interpelancë është dorëzuar mjaft kohë para afatit, prapëseprapë nuk është përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së Kryesisë më 1 nëntor (shiko pikën e dytë nën titullin “Rendi i ditës”) kështu që akoma nuk i është përcjellur Qeverisë. Sipas rregullës 25, “propozimin për shqyrtimin e një çështjeje të caktuar lidhur me punën e Qeverisë ose të ministrive, mund të paraqesin jo më pak së dhjetë (10) deputetë . . . Interpelanca i parashtrohet Kryesisë së Kuvendit. Kryesia e Kuvendit, menjëherë sapo ta ketë marrë tekstin e interpelancës, ia dërgon Qeverisë, që është e detyruar ta shqyrtojë brenda jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditësh . . . Interpelanca vihet në rendin e ditës në afatin prej dhjetë (10) ditësh, pasi të merret përgjigja nga Qeveria. Në qoftë se Qeveria në afatin e paraparë me paragrafin 4 nuk e dërgon përgjigjen lidhur me interpelancën, interpelanca vihet si pikë e fundit në rendin e ditës të seancës plenare të Kuvendit që është duke u zhvilluar. Nëse Kuvendi nuk është për seancë, atëherë ajo vihet si pikë e parë në rendin e ditës së seancës së parë të radhës të Kuvendit. Kuvendi nuk mund ta refuzojë vënien e interpelancës për shqyrtim në rendin e ditës, përveç në rast se ajo nuk i plotëson kushtet formale sipas paragrafit 3 të kësaj rregulle.”¹² Siç është përmendur më herët në këtë raport, Kryesia nuk ia ka përcjellur mocionin e interpelancës Qeverisë “sapo e ka marrë tekstin e interpelancës”, siç kërkohej nga rregulla 25.

Formimi i Komisionit për siguri

- Më 10 tetor, Komisioni për gatishmëri emergjente i ka dorëzuar Kryesisë një kërkesë që “(1) të përshpejtohet procedura për formimin e komisionit parlamentar që do të përcjellë fushën e sigurisë; dhe (2) të qartësohet nevoja e ekzistimit të mëtutjeshëm të Komisionit për gatishmëri emergjente”. Më 1 nëntor, Kryesia e ka shqyrtuar propozimin e komisionit dhe ka konkluduar se Kuvendi duhet të vendosë nëse Komisioni për gatishmëri emergjente duhet të shpërbëhet dhe të zëvendësohet nga një Komision i ri për siguri, apo nëse Komisioni për gatishmëri emergjente duhet të vazhdojë të ekzistojë pranë Komisionit të ri për siguri. Kryesia ka nxjerrë një përfundim me shkrim, me të cilin “(1) mbështetet kërkesa e Komisionit për gatishmëri dhe emergjencë për ta formuar Komisionin për siguri; (2) kërkohej nga grupet parlamentare që t’ia propozojnë Kuvendit kandidatët për anëtarë të Komisionit për siguri, sipas numrit të anëtarëve të deritanishëm në Komisionin për gatishmëri dhe emergjencë; (3) kandidatët e propozuar duhet të kenë njohuri për fushën e sigurisë; (4) propozimet t’i dërgohen Kryesisë së Kuvendit deri më 10 nëntor 2005.” Përfundimi me shkrim i Kryesisë nuk përmendte çështjen nëse Komisioni për gatishmëri emergjente duhej të shpërbëhej, dhe as nuk bënte të ditur se kjo çështje do të

¹¹ Sipas rregullës 26.4, asnjë deputet, një ministri nuk mund t’ia parashtrorë më shumë se dy pyetje për përgjigje me gojë cilëndo ditë, kështu që nuk duhet t’i kërkohej Kryeministrit që të përgjigjet në të tri pyetjet e z. Kelmendi në të njëjtën ditë. Për më saktë, z. Kelmendi është dashur të udhëzohet që t’i kufizojë pyetjet e tij në dy për një Ministër të caktuar.

¹² Rregulla 25.3 parasheh që mocioni duhet të jetë me shkrim dhe të përfshijë: “formulimin e saktë të çështjes që është lëndë e interpelancës, konkluzionin që propozohet dhe arsyetimin, emrin dhe mbiemrin e deputetit, që e ka parashtruar interpelancën në Kuvend, si dhe nënshkrimet e deputetëve, që e mbështetin interpelancën.”

përcaktohej nga Kuvendi në seancë plenare. Kur Kuvendi u mbledh në seancë plenare më 17 dhe 21 nëntor, Kuvendi kishte marrë propozime për anëtarë të komisionit nga PDK-ja (z. Sokol Bashota, z. Emin Krasniqi, z. Xhevat Bislimi), AAK-ja (z. Naim Maloku, poashtu i propozuar për kryesues të komisionit me supozimin se Komisioni për gatishmëri emergjente do të shndërrohej në Komisionin për siguri), ORA (z. Ylber Hysa), dhe 6+ (z. Džezair Murati). Propozimet nuk ishin marrë nga grupi parlamentar i LDK-së dhe SLKM-së.

Në seancën plenare më 17/21 nëntor, Kryesuesi i paraqiti propozimet dhe i lexoi me zë emrat e anëtarëve të komisionit të propozuar nga secili grup parlamentar, dhe gjithashtu në emër të LDK-së e përmendi z. Agim Krasniqi, z. Fadil Geci, znj. Samije Zeqiraj, z. Fadil Kryeziu dhe znj. Qibrrije Hoxha; dhe znj. Vesna Jovanović në emër të SLKM-së. Kryesuesi i seancës plenare shtoi se propozimet për kryesues të komisionit, zëvendëskryesues të parë dhe zëvendëskryesues të dytë ishin z. Maloku, z. Hysa, përkatësisht z. Krasniqi. Pasi që është këshilluar nga Drejtori i departamentit për mbështetje ligjore dhe procedurale, Kryesuesi shtoi se meqë as LDK-ja as SLKM-ja nuk i kishin dorëzuar propozimet, emrat e anëtarëve të tyre në Komisionin për gatishmëri emergjente i ishin shtuar listës nga ana e administratës së Kuvendit. Z. Alush Gashi (LDK) deklaroi se “nuk ka nevojë që të falsifikohen të dhënat”, duke argumentuar se edhe pse LDK-ja e mbështeste nismën për formimin e Komisionit për siguri, Kuvendi asnjëherë s’kishte marrë vendim për *shpërbërjen* e Komisionit për gatishmëri emergjente. Ai kërkoi nga Kryesia që të shpjegonte se kur ishte marrë një vendim i tillë dhe se administrata nuk kishte të drejtë të caktonte anëtarët e LDK-së në komision. Z. Fatmir Sejdiu (LDK) deklaroi se Kryesia *nuk* kishte vendosur nëse Komisioni për gatishmëri emergjente duhet të shpërbëhej, por ka konkluduar se ky vendim duhet të merret nga Kuvendi. Z. Sejdiu shtoi se LDK-ja do t’i propozonte anëtarët e saj për Komisionin për siguri vetëm pasi të qartësohet nëse Komisioni për gatishmëri emergjente do të vazhdojë të ekzistojë. Z. Jakup Krasniqi (PDK) u pajtua me z. Gashi se “duhet të ndërpritet praktika e marrjes së vendimeve jashtë Kuvendit” dhe shtoi se nëse Kuvendi vendos që Komisioni për gatishmëri emergjente të vazhdojë të ekzistojë pranë Komisionit të ri për siguri, PDK-ja do të propozojë emra të tjerë. Znj. Gjylnaze Sylja (AAK) rikujtoi se Kuvendi ishte pajtuar që AAK-ja ta mbante postin e kryesuesit të Komisionit për gatishmëri emergjente dhe nëse ky komision *zëvendësohet* nga Komisioni i ri për siguri, AAK-ja do të duhej ta kryesonte komisionin e ri. Znj. Sylja poashtu ua rikujtoi deputetëve se Kuvendi kishte vendosur ta zvogëlonte numrin e komisioneve nga 19 në njëmbëdhjetë dhe do të duhej ta respektonte këtë parim në vend se ta rriste numrin e përgjithshëm të komisioneve. Z. Hysa (ORA) propozoi që të bëhej debat më i gjërë për këtë çështje, duke shtuar se kishte pasur një varg problemesh lidhur me formimin e komisionit. Kryesuesi i seancës plenare propozoi që kjo pike e rendit të ditës të shtyhej derisa të arrihej një marrëveshje në mes të Kryesisë dhe grupeve parlamentare

Përfundimi me shkrim i Kryesisë, i shpërndarë grupeve parlamentare, ka bërë pak për të qartësuar fatin e Komisionit për gatishmëri emergjente apo për t’i udhëzuar grupet parlamentare se si të procedojnë me formimin e Komisionit për siguri. Siç është përmendur më herët, Kryesia ka konkluduar në mbledhjen e saj më 1 nëntor se Kuvendi është ai që duhet të vendosë për fatin e Komisionit për gatishmëri emergjente e jo Kryesia, kështuqë në kohën kur është shkruar përfundimi, nuk është ditur se çka do të ndodhë me komisionin. Megjithatë, dokumenti që u është shpërndarë grupeve parlamentare nuk i referohej përfundimit të arritur në mbledhjen e Kryesisë – se do të kërkohet nga Kuvendi të vendosë nëse Komisioni për gatishmëri emergjente duhet të vazhdojë të ekzistojë. Siç duket, shumica e grupeve parlamentare i kanë dhënë propozimet e tyre duke supozuar se komisioni nuk do të ekzistonte më dhe se do të shndërrohej në Komision të ri për siguri, meqë emrat e dorëzuar nga PDK-ja, AAK-ja, ORA, dhe 6+ përputheshin plotësisht me anëtarët e tanishëm të Komisionit për gatishmëri emergjente. Sikur të kishin menduar këto grupe parlamentare se Komisioni për gatishmëri emergjente do të vazhdonte të ekzistojë, ata sipas të gjitha gjasave do të kishin propozuar anëtarë të tjerë për komisionin e ri. Andaj, nuk duhet të kërkohet nga grupet parlamentare që të propozojnë anëtarë për Komisionin për siguri para se të përcaktohet fati i Komisionit për gatishmëri emergjente. Kur të vendoset për anëtarësinë dhe kryesinë e Komisionit për siguri, duhet të merret parasysh se sipas nenit 9.1.22 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullës 48.8, “të paktën njëri prej tyre

zëvendëskryesuesve duhet të jetë i komunitetit tjetër nga ai i kryesuesit.” Propozimi që është dhënë fillimisht gjatë seancës plenare, sipas të cilit kryesuesi do të ishte nga AAK-ja dhe zëvendëskryesuesit nga LDK-ja dhe ORA, do të ishte në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese dhe Rregulloren e Kuvendit.

Rezoluta për statusin e Kosovës

- Më 10 nëntor, shefat e grupeve parlamentare, Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativ dhe Kornizë Kushtetuese arritën një marrëveshje për tekstin e rezolutës së propozuar për statusin e Kosovës.¹³ Para seancës plenare më 17 nëntor, Kryesia e Kuvendit është takuar për të diskutuar një propozim për amendamentimin e rezolutës, me ç'rast u konkludua se një grup punues prej shtatë anëtarësh (dy nga LDK-ja, dy nga PDK-ja, një nga AAK-ja, një nga ORA dhe një nga 6+) do të hartonte një rezolutë të re dhe t'ia paraqiste Kuvendit më vonë gjatë asaj dite. Kryetari i Kuvendit e mbledhi Kuvendin për një kohë të shkurtër në mesditë për ta informuar Kuvendin me zhvillimet e deri atëherëshme. Në ora 3:00 pasdite, pesë orë më vonë nga koha kur është dashur të fillonte seanca plenare, Kuvendi u rimblodh. Kryetari i Kuvendit i falënderoi të gjithë të pranishmit për mirëkuptim dhe njoftoi se pas “dyzet e pesë ditësh pune pa ndërprerje”, është arritur marrëveshja për një tekst të cilin e mbështesnin të gjithë. Znj. Nekibe Kelmendi (LDK), anëtare e grupit punues që e ka hartuar tekstin, e lexoi me zë tërë tekstin, pas së cilës gjë të gjithë deputetët e Kuvendit u ngritën dhe duartrokitën në shenjë miratimi. Rezoluta që “rikonfirmon vullnetin e popullit të Kosovës për Kosovën Shtet të pavarur dhe sovran” nuk është votuar formalisht nga Kuvendi, por kuptohej plotësisht se është miratuar me aklamacion.

Rregullorja e punës parasheh se votimi duhet të bëhet me “ngritje të dorës, votim të fshehtë . . . votim elektronik, apo me thirrje të secilit deputet veç e veç.” Miratimi me aklamacion nuk përmendet shprehimisht si mënyrë votimi në Rregulloren. Megjithatë, ishte plotësisht e qartë se rezoluta e kishte mbështetjen e shumicës dërrmuese të deputetëve të pranishëm.

Propozimi për hartimin e një Kushtetute të re

- Më 21 tetor, grupi parlamentar i AAK-së i ka dorëzuar Kryesisë një propozim për hartimin e një kushtetute të re. AAK-ja ka propozuar që grupi punues përgjegjës për hartimin e kushtetutës të përbëhet nga shefat e grupeve parlamentare; Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativ dhe Kornizë kushtetuese; dhe Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Kryesia e ka shqyrtuar propozimin gjatë mbledhjes së saj më 1 nëntor dhe e ka përfshirë në rendin e ditës të seancës plenare të 17/21 nëntorit. Në seancë plenare, Kryesuesi njoftoi se Kryesia kishte vendosur të propozojë që Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativ dhe Kornizë kushtetuese ta hartonte kushtetutën e re, në bashkëpunim me Qeverinë dhe Zyrën Ligjore të UNMIK-ut. Z. Alush Gashi (LDK) deklaroi se LDK-ja kërkonte krijimin e një komisioni të ri për hartimin e kushtetutës. Z. Jakup Krasniqi (PDK) u përgjigj se PDK-ja e mbështeste nismën për hartimin e kushtetutës së re, por dëshiroi t'ua rikujtonte deputetëve se grupi negociator tashmë planifikonte të formonte një komision për hartimin e dokumentave, përfshirë edhe kushtetutën e re, dhe sugjeroi që kjo çështje të debatohet më gjerësisht. Znj. Gjylnaze Sylja (AAK) deklaroi se është Kuvendi ai që duhet ta hartojë kushtetutën e re, dhe shtoi se kushtetuta duhet të jetë e gatshme *para negociatave*, në mënyrë që ta ndihmojë grupin negociator. Z. Mahir Yagcilar (6+) e shprehu mbështetjen e grupit të tij parlamentar për nismën dhe shprehi dëshirën që të jetë të përfaqësuar në grupin punues të ngarkuar për hartimin e kushtetutës. Znj. Teuta Sahatqija (ORA) deklaroi se kushtetuta e re duhej të trajtohej si çështje mbipartiake dhe madhore, dhe shtoi se Kuvendi tashmë ishte zotuar për hartimin e kushtetutës së re me rastin e miratimit të rezolutës më 17 nëntor, kështuqë ajo nuk e konsideronte të nevojshme të votohej përsëri. Z. Fatmir Sejdiu (LDK) deklaroi se nuk besonte që grupi negociator do të ketë rol në hartimin e kushtetutës së re dhe u pajtua se Kuvendi duhet ta formojë një grup të posaçëm punues për hartimin e kushtetutës, por propozoi që Kuvendi mund ta votonte vetëm *nismën* për hartimin e

¹³ Shiko raportin 08/2005 të Shtyllës III (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

kushtetutës, dhe se Kryesia mund të arrinte më vonë një marrëveshje me shefat e grupeve parlamentare në lidhje me përbërjen e grupit punues. Kryesuesi e ftoi Kuvendin të votonte dhe propozimi u miratua pa vota kundër. Z. Alush Gashi theksoi edhe një herë se Kuvendi në atë rast kishte votuar vetëm për nismën për hartimin e kushtetutës, dhe se për përbërjen e grupit punues do të vendoste më vonë Kryesia.

Pajisja elektronike e votimit

- Pajisja elektronike e votimit është përdorur shumë herë gjatë seancës plenare në fjalë, meqë kishte një numër të madh amandamentesh të propozuara në projektligjet në shqyrtim të dytë. Gjatë tërë rrjedhës së votimit, ngjyrat që paraqisnin votat për, votat kundër dhe abstenimet vazhdimisht ndryshonin. Në seancën plenare të 17/21 nëntorit, votat për janë paraqitur së pari me ngjyrën rozë, pastaj me atë të portokalltë, të kaltërt, bruz të çelët, të gjelbër, dhe në fund me atë të verdhë.

Ky problem teknik është përmendur në një raport të mëhershëm, me rastin e përdorimit të parë pajisjeve elektronike për votim gjatë seancës plenare.¹⁴ Secili lloj i votave duhet të paraqitet vazhdimisht me një ngjyrë, në mënyrë që rezultatet e votimit të shfaqen më qartë. Nëse, për shembull, ngjyra rozë fillimisht përdoret për t'i treguar votat për dhe ngjyra e gjelbër për t'i treguar votat kundër, dhe ngjyrat më vonë zëvendësohen me njëra-tjetrën, atëherë rezultati i votimit do të dukej pikërisht i kundërt, posaçërisht për ata të cilët nuk mund t'i shohin numrat e që duhet të mbështeten në ngjyrat.

Vështirësitë procedurale dhe vonesat për shkak të sistemit mujor të mbajtjes së seancave plenare

Raportet e shtyllës së III-të (OSBE) kanë theksuar një numër vështirësish procedurale që kanë rezultuar që kur Kuvendi në shkurt 2004 ka filluar t'i mbajë seancat plenare një herë në muaj.¹⁵ Komenti në pjesën "Shpërndarja e dokumenteve" të këtij raporti thekson vështirësinë e renditjes së projektligjeve në shqyrtim të parë në pajtim me rregullën 35.1 për shkak të sistemit mujor të mbajtjes së seancave plenare. Për më tepër, shtyerja e disa pikave gjatë periudhës raportuese shërben si ilustrim klasik i vonesave që shumë lehtë mund të rezultojnë për shkak të sistemit mujor të mbajtjes së seancave. Shqyrtimi i parë i dy projektligjeve sipas të gjitha gjasave do të shtyhet për një muaj për shkak të pohimit të Kryesuesit se zëvendësministrat nuk mund t'i paraqesin projektligjet në Kuvend dhe për shkak të ngurrimit të Kuvendit që seanca plenare të zgjatej edhe

¹⁴ Shiko raportin 06/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

¹⁵ Shiko, në veçanti, raportin 04/2004 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës: "Në mbledhjen e Kryesisë më 4 maj (2004), z. Hydajet Hyseni (PDK) ka thënë se Kryesia "po e përfundonte çdo seancë me shkelje procedurale" duke mos i paraqitur Kuvendit rendin e ditës për seancën plenare të radhës për votim. Kryetari i Kuvendit ishte pajtuar se duhet përmirësuar këtë praktikë. Z. Hyseni kishte shtuar se ishte e vështirë të propozohej rendi i ditës një muaj më herët, dhe se ndoshta Kuvendi do duhej të miratonte një sistem të mbajtjes së seancave plenare çdo dy javë në vend të sistemit mujor që Kuvendi e kishte filluar në shkurt 2004. Kryetari i Kuvendit e refuzoi propozimin duke u përgjigjur se Kryesia e kishte miratuar vendimin për mbajtjen e seancave plenare mujore. *Sic është shënuar në raportet e mëhershme, Kuvendi vazhdimisht ka dështuar t'i përmbahet rregullave 6 dhe 17 [rregulla e tanishme 23] në lidhje me miratimin e rendeve të ditës të seancave plenare që kur ka filluar të takohet një herë në muaj në shkurt 2004 . . . Saktësia e deklaramentit se Kryesia e kishte miratuar vendimin për mbajtjen e seancave plenare një herë në muaj në vend se një herë në javë është e diskutueshme meqë jo të gjithë anëtarët e Kryesisë ishin pajtuar me propozimin dhe nuk kishte pasur votim formal."* Raporti 05/2004 i Shtyllës së III-të (OSBE) ka vërejtur se "sistemi i mbajtjes së seancave plenare në baza mujore duket se po e komplikon planifikimin e shqyrtimeve të para të projektligjeve. Në rastet kur Kuvendi e merr projektligjin nga Qeveria në kohën kur zyra për parashtrëse e ka të pamundur t'ua shpërndajë projektligjet deputetëve së paku dhjetë ditë pune para seancës së ardhshme plenare, sipas sistemit mujor shqyrtimi i parë ose duhet të planifikohet në kundërshtim me rregullën 28.2 (rregulla e tanishme 35.1) ose më shumë se një muaj pas shpërndarjes." Raporti 02/2005 i Shtyllës së III-të (OSBE) vëren se "Tendenca e përgjithshme e kohëve të fundit në Kuvend është që të kufizohet në minimumin absolut debatimi gjatë shqyrtimeve të dyta, ndoshta për shkak të sasisë së madhe të projektligjeve që duhet të shqyrtohen në çdo seance plenare njëherë në muaj dhe nga ndjenja e nevojës për nguti gjatë shqyrtimeve të dyta. Në të kaluarën, kur Kuvendi mbante seanca plenare javore, rendi i zakonshëm i ditës përfshinte dy ose tre projektligje dhe secilit projektligj i kushtohej më shumë kohë, si në shqyrtim të parë, ashtu edhe në të dytin." Shiko poashtu edhe të gjitha raportet e Shtyllës së III-të (OSBE) pas shkurtit 2004 mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

për një ditë në mënyrë që t'i mundësohej Minsitrit përkatës t'i paraqesë projektligjet.¹⁶ Formimi i Komisionit për siguri është shtyrë gjithashtu për seancën e ardhshme plenare, gjë e cila prapë do të rezultojë në një vonesë të mundshme prej të paktën një muaji. Ngjashëm, dështimi për të shqyrtuar mocionin e PDK-së për interpelancë dhe propozimin e ORA-s për mbajtjen e dy debateve plenare, në mbledhjen e Kryesisë më 1 nëntor, do të thotë se të dy mocionet do të shtyhen së paku për një muaj. Edhe pse Kryesia ndonjëherë mblidhet më shpesh se një herë në muaj, mbledhjet e saj të rregullta zakonisht korrespondojnë me seancat plenare, ndërsa mbledhjet shtesë thirren vetëm kur e kërkojnë rrethanat.¹⁷ Mirëpo, nuk është thirrur asnjë mbledhje shtesë gjatë periudhës raportuese (që përfundon më 25 nëntor) për të shqyrtuar propozimin e ORA-s të datës 25 tetor për mbajtjen e dy debateve plenare, mocionin e PDK-së të datës 25 tetor për interpelancë, apo propozimin e ORA-s të datës 7 nëntor për të thirrur një seancë të jashtëzakonshme plenare, ku dy të fundit sipas definicionit janë kërkesa urgjente. Për më tepër, një numër dispozitash të Rregullores, siç është rregulla 35.1 (shiko komentin nën titullin “Shpërndarja e dokumentave”) dhe rregulla 23.1 (shiko pikën e parë nën titullin “Rendi i ditës”), thjesht nuk përputhen me sistemin mujor të mbajtjes së seancave plenare. Kuvendi do të mund ta shqyrtonte seriozisht mundësinë e kthimit në sistemin javor të mbajtjes së seancave plenare ose t'i mbajë seancat plenare të paktën çdo dy javë.

4. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve

- Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve në mbledhjen e tij më 31 tetor e ka diskutuar projektligjin për Radio Televizionin e Kosovës (RTK). Përfaqësuesit e komunitetit boshnjak dhe goran në komision bënë vërejtje në atë që pjesëtarët e komuniteteve të tyre pritet që ta bëjnë parapagimin për RTK-në edhe në vendet ku ata jetojnë nuk ka transmetim të sinjaleve të RTK-së. Komisioni i ka dërguar komisionit funksional¹⁸ rekomandimin me shkrim në të cilin pohonin se amandamenti 13 (i cili cakton parapagimin mujor prej 3.5 Euro), i propozuar nga komisioni funksional, i cënon të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe propozonin që komisioni funksional të precizojë se disa pjesë të Kosovës ku nuk ka transmetim të sinjaleve televizive “të lirohen nga parapagimi televiziv deri në sigurimin e kushteve teknike për emetimin e programit të RTK-së”. Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve poashtu i ka propozuar edhe nëntë amandamente shtesë në këtë projektligj. Komisioni funksional, në mbledhjen e tij më 10 nëntor, e ka shqyrtuar rekomandimin për lirim nga parapagimi mujor të disa prej viseve të Kosovës, por e ka refuzuar atypëraty. Gjithashtu i ka refuzuar edhe të gjitha amandamentet e propozuara nga Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, përveç njërit.¹⁹
- Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media, në mbledhjen e tij të 10 nëntorit, ka vendosur t'i rekomandojë Kryesisë që të shtyhet shqyrtimi i mëtutjeshëm i projektligjit për përdorimin e gjuhëve derisa të amandamentohet Korniza Kushtetuese, me arsyetimin se projektligji mund të jetë në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese të amandamentuar apo me kushtetutën e re. Komisioni, sidoqoftë, përmes rekomandimit me shkrim që i është dërguar më vonë Kryesisë, thjesht kërkonte më shumë kohë për shqyrtimin e projektligjit për shkak të rëndësisë së tij të madhe.

¹⁶ Në fund të seancës më 21 nëntor, Kryesuesi propozoi që seanca plenare të vazhdonte më 22 nëntor për t'u marrë vesh me Ministrin që t'i paraqesë të dy projektligjet në fjalë. Ky propozim, sidoqoftë, është kundërshtuar zëshëm nga deputetët e Kuvendit, kështu që Kryesuesi njoftoi se këto projektligje do të përfshiheshin në rendin e ditës së seancës ardhshme plenare, e cila mbetet të caktohet.

¹⁷ Për shembull, Kryesia zyrtarisht ka mbajtur dy mbledhje në shtator (14 dhe 20 shtator), por kjo ka ndodhur për shkak se anëtarët i kanë marrë materialet për mbledhjen e 14 shtatorit tepër vonë dhe kanë vendosur në atë mbledhje që t'i ndalonin punimet dhe të mblidheshin një ditë tjetër (20 shtator).

¹⁸ Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media.

¹⁹ Komisioni funksional i ka refuzuar shtatë prej nëntë amandamenteve dhe e ka miratuar një amandament në mbledhjen e tij më 10 nëntor. Amandamenti i fundit është diskutuar dhe refuzuar në një mbledhje të mëvonshme, pasi që është kërkuar sqarimi shtesë nga Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

5. Qasja

Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancën plenare, në mbledhjen e rregullt të Kryesisë dhe në shumicën e komisioneve. Shtyllës së III-të (OSBE) dhe vëzhguesve të tjerë, përfshirë edhe asistentët e grupeve parlamentare, u është kërkuar ta lëshonin mbledhjen e Komisionit për shërbime publike, administratë lokale dhe media pas paraqitjes së komenteve nga ana e Komisionerit të përkohshëm të mediave në projektligjin për RTK-në, në mbledhjen e 25 tetorit. Arsyetimi nuk është dhënë. Shtylla e III-të (OSBE) gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

6. Transparenca

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar transmetim të drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web faqen (www.kuvendikosoves.org, www.skupstinakosova.org, www.assemblyofkosovo.org). që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera.

FUND.